

# **AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

## **"DMALBAR" SHPK**

### **KREU I**

#### **EMRI I SHOQERISË ,SELIA,KOHËZGJATJA,OBJEKTI**

Bazuar në kërkesat e ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "**DMALBAR**" SHPK, me ortakë themelues:

**Z.Dorian Pali**, shtetas Shqiptar, i biri i Pal,i datëlindjes 01.03.1979, lindur në Lezhë, dhe banues në Lagja Beslidhja,Lezhë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me dokument identifikimi me numër personal H90301032V.

**Znj.Merita Pali**, shtetase Shqiptare, i bija e Petrit, e datëlindjes 29.08.1984, lindur në Divjake, dhe banuese në Lagja Beslidhja,Lezhë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me dokument identifikimi me numër personal I45829041U .

Sot me datë 07.03.2024, kemi vendosur të themelojme në Lezhe, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**DMALBAR**" SHPK

### **NENI I**

#### **SELIA**

Selia e shoqërise ndodhet në adresen : Lezhë, Balldre i Vjeter, zona kadastrale nr.1086, numer pasurie 481\100. Asambleja e Shoqërise ka të drejtë të ndryshojë selinë ,të hapë zyra, përfaqësi dhe filiale edhe në rrethet e tjera të vendit si dhe jashtë shtetit.

### **NENI II**

#### **FORMA JURIDIKE DHE KOHZGJATJA**

Forma juridike e shoqërisë është “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”.

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë është e pakufizuar në kohë.

### NENI III

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

"DMALBAR" SHPK ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

- a) Prodhim, grumbullim dhe përpunim i frutave dhe perimeve ;
- b) Import ,prodhim, grumbullim dhe përpunim i frutave të thata;
- c) Tregti me shumicë dhe pakicë e produkteve të përpunuara , lëndës së parë të prodhur vetë dhe produkte të subjekteve të tjera ;
- d) Prodhim dhe shitje e byrekëve ;
- e) Prodhim dhe shitje e lëngjeve nga fruta perime të shtrydhura në çast ;
- f) Grumbullim dhe përpunim i bimëve medicinale dhe aromatike

Për përmbushjen e objektit të saj shoqëria :

- a) Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë truall apo objektësh, operatorë dhe administrues të aktiviteteve brenda objektit;
- c) Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ,të dobishme ose që kanë të bëjnë me fushën, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim me të mire të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre. Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë

saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushje ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

#### **NENI IV**

##### **KAPITALI I SHOQERISË**

4.1 Kapitali i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë. Të ndara në 2 kuota, të cilat përbëjnë 100% të kapitalit:

**Z.Dorian Pali, 1 kuotë ose 50% të kapitalit.**

**Znj.Merita Pali, 1 kuote ose 50 % te kapitalit**

Kapitali i Shoqerise nënshkruhet menjehere dhe do paguhet nga ortakët.

4.2 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

#### **NENI V**

##### **KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT**

**5.1** Në rast se një ortak apo një bashkzotëues i një kuote humb jetën trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmit persona që do të njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria; por asnjë nga këto parashikime nuk çliron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimin të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

**5.2** Personi që fiton të drejtën mbi një kuote si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotëues i kuotes ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëues i kuotës, ai njofton

Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mësipërm zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës, por gjithmonë ortakët ekzistues do kenë të drejtën e parablerjes.

**5.3** Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përiashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotërues i kuotës.

**5.4** Kontrata për transferimin e pjesës së kapitalit duhet të jetë në formën e aktit noterial dhe në rast se pronari i ri nuk është ortak i shoqërisë, duhet të deklarojë shprehimisht në kontratë se është njohur me aktin e themelimit të shoqërisë dhe STATUTIN e shoqërisë dhe se është dakort me to. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

**5.5** Administratori mund të refuzojë rregjistrimin e kalimit të kuotës në QKB në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose se në rast se administratori nuk është dakort me personin të cilit i kalon kuota.

**5.6** Nëse administratori apo administratorët refuzojnë ta rregjistrojnë kalimin e kuotes, ata njoftojnë për mospranimin e personit të cilit i kalon kuota. Brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për rregjistrimin e kalimit të kuotes.

## **NENI VI**

### **ZMADHIMI I KAPITALIT**

**6.1** Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 8.12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'u komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.

**6.2** Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë te drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.

**6.3** Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish te drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

## **NENI VII**

### **ZVOGETIMI I KAPITALIT**

**7.1.** Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 8.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

**7.2.** Ortakët e perballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## **ORGANET DREJTUESE**

### **NENI VIII**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**8.1** Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrvëshje midis ortakëve të Shoqërisë.

**8.2** Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjeset e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

8.3 Çdo ortak mund të përfaqsohet nga nje ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.

8.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

8.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call audio ose video), në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

8.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/t ose nga ortakët që përfaqsojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar sejcilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

8.7 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.

8.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/t. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.

8.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të behen me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.

8.10 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 [gjashtë] muajve nga mbyllja e vitit financiar.

8.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 8.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

8.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

## **NENI IX**

### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

Ortaku ka të drejtë të informohet lidhur me administrimin e shoqërisë, të njihet me bilancin vjetor dhe të kërkojë me shkrim sqarime të cilat i jep administratori në mbledhjen e asamblesë.

1-Secili nga ortakët ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës tërheqjen nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.

2-Sejcili ortak që nuk është administrator, ka të drejtë t'i paraqesë dy herë në vit administratorit pyetje lidhur me problemet, egzistenca e të cilave vë në dyshim

vazhdimesinë e aktivitetit të shoqërisë. Lidhur me përgjigjen e administratorit vihet në dijeni edhe eksperti kontabel i autorizuar.

3-Në rast se shoqëria nuk ka ekspert kontabel të autorizuar atëherë emerimi i një eksperti kontabël i autorizuar mund të kërkohet në rrugë gjyqesore nga një ose disa ortakë, pjesa e kapitalit të të cilave përfaqësojnë 5% e kapitali themeltar.

4-Një ose disa ortakë, pjesa e kapitalit të të cilave së bashku përfaqësojnë 5% të kapitalit themeltar, mund të kërkojnë në rrugë gjyqësore caktimin e një ose disa ekspertëve të ngarkuar për paraqitjen e nje raporti për një ose disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorëzohet ortakut/ortakëve që kanë bërë kërkesën administratorit, eventualisht ekspertëve kontabël të autorizuar në qofte se janë emëruar, raporti paraqitet në mbledhjen e ardhshme të asamblesë.

5-Ortaku nuk mund të marrë hua nga shoqëria, të miratojë në emër të shoqërisë paradhëniet apo të bëhet garant për detyrimet ndaj personave të tretë. Në rast të kundërt veprimi është i pa vlefshëm, kjo vlen edhe përfaqësuesin ligjor të tij, bashkeshortin si dhe paraardhësin dhe pasardhësin e tij.

6-Ortaku i personit juridik është i detyruar që mënjëherë të njoftojë ortakët e tjerë lidhur me ndryshimin e statutit ose të përbërjes së organëve të tij.

7-Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë te një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

9-Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

## **NENI X**

### **ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**10.1** Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhe prej 5 (pese) vjetesh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

**10.2** Administratori zoteron kompetenca të plota ne lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron ta nevojshme per



realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

**10.3** Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare ta vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

**10.4** Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

**10.5** Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë **Z. Dorian Pali**, shtetas shqiptar, i lindur në Troshan, me **01.03.1979**, identifikuar me kartë identiteti nr. 036021147 dhe numër personal H90301032V , me afat **5-së vjeçar** me të drejtë përsëritje.

## **SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT**

10.6 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

## **NENI XI**

### **PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT**

**11.1** Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a) i përfundon mandati;
- b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;

- c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

## **NENI XII**

### **KONTROLLI FINANCIAR**

12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emëroje një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

## **NENI XIII**

### **VITI FINANCIAR**

13.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

## **NENI XIV**

### **BILANCI VJETOR**

14.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

14.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

## **NENI XV**

## **DIVIDENDI**

**15.1** Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

15.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe ,nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, te gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara ne kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat giatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividend.

## **NENI XVI**

### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

**16.1** Ne rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

## **NENI XVII**

### **LIGJI I ZBATUESHEM**

**17.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Akt Themelimi ,Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

## **NENI XVIII**

**18.1** Mosmarrveshjet qe mund të lindin ndermjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndermjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do te zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje

miqësore, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshë Lezhë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre)kopje në gjuhën shqipe.

## ORTAKET

Merita Pali



Dorian Pali

